

## **Këshilltar Ligjor i Gjykatës së Lartë**

Saimir Nazifi ka lindur më 15 nëntor 1963. Është i martuar dhe ka dy fëmijë. Në vitin 1992-1996 kreu studimet në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, duke u diplomuar “Jurist”.

Në periudhën dhjetor 1993- prill 2003 ka ushtruar detyrën e ndihmës-gjyqtarit dhe gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër. Në periudhën prill 2003 - maj 2013 ka ushtruar detyrën e Avokatit të Shtetit. Në vitin 2007 ka mbrojtur titullin Avokat, pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë Tiranë.

Në vitin 2013 është emëruar dhe ushtron detyrën e Këshilltarit Ligjor të Gjykatës së Lartë, si dhe prej vitit 2019 ushtron edhe detyrën e Këshilltarit Ligjor, pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.